

Date 14/05/2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Blerje pjesë këmbimi, vaj dhe goma", e ndarë ne lote":Loti 1 "Blerje Pjesë Këmbimi"; Loti 2 "Blerje goma"; Loti 3 "Blerje vaj, filtra dhe materiale të tjera".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Vajrave lubrifikuese dhe agjentët lubrifikues 09211000-1

Vajra motorike 09211100-2

Bateri 31440000-2

Pjesë këmbimi për automjete, furgonë dhe makina transporti mallrash 34330000-9

Goma për automjete të rënda 34352000-9

Goma për kamionët 34352100-0

Filtra vaji 42913300-2

Filtra naftë 42913400-3

VLERA E FONDIT LIMIT: "Blerje pjesë këmbimi, vaj dhe goma", e ndarë ne lote" me një fond limit total prej 4,514,124 (katër milion e pesëqind e katërmëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e katër) lekë pa TVSH: Loti 1 "Blerje Pjesë Këmbimi" me fond limit 1,249,467 (një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH; Loti 2 "Blerje goma" me fond limit 1,496,000 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH, Loti 3 "Blerje vaj, filtra dhe materiale të tjera" me fond limit 1,768,657 (një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.
Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit dhe "Vetëfinancim".

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Loti 1 "Blerje Pjesë Këmbimi"

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.
2. Të jetë i specifikuar në QKB objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik i njëjtë ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcen 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023-2024-2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së secilit prej loteve/shumatores se loteve për të cilat konkuron.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe pikat 1,2,3 të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për **këstet e maturuara të vitit 2026** sipas afateve të përcaktuara në ligjin 9632/2006 “Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kësaj deklarate duhet ti bashkëngjiten të gjithë vërtetimet që deshmojnë se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet perkatese**, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për këtë periudhë.

Shënim: Ky kriter (2.2.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 pika 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likjuar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së secilit prej loteve/shumatores se loteve për të cilat konkuron.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 55, pika 4b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Ofertuesit duhet të paraqesin Çertifikate ISO 9001:2015, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësive dhe /ose të njëvlefshme, të cilat do të garantojnë cilësinë e produktit ose standart ISO më të avancuar, të perkthyer dhe noterizuar. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme dhe të lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të cilët janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar ne te cilen gjejme te percaktuar se:” 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë“.

Ky kriter gjen mbështetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar ku percaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr.145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te dorezoje nje deklarate me ane te se ciles deklaron se do te beje dorezimin e mallrave sipas sasise dhe specifikimeve teknike te kerkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 6 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky vetdeklarim kërkohet per ti vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të produkteve objekt prokurimi.

Ofertuesi i kualifikuar i pari duhet te dorëzoje përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe brenda afatit te percaktuar ne kerkesen per dorezim dokumentacioni prane AK, dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të parashikuara në pikën 2 të nenit 26 te VKM-se 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI 2 “BLERJE GOMA”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

3. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.
4. Të jetë i specifikuar në QKB objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik i njëjtë ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcen 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023-2024-2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së secilit prej loteve/shumatores se loteve për të cilat konkuron.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe pikat 1,2,3 të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për **këstet e maturuara të vitit 2026** sipas afateve të përcaktuara në ligjin 9632/2006 “Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kësaj deklaratë duhet ti bashkëngjiten të gjithë vërtetimet që deshmojnë se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet perkatese**, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për këtë periudhë.

Shënim: Ky kriter (2.2.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 pika 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave

dhe tarifave vendore, në vëndet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së secilit prej loteve/shumatores se loteve për të cilat konkuron.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi ***dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.***
- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi ***dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.***

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

2.3.2 Ofertuesit duhet të paraqesin Çertifikate ISO 9001:2015, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësive dhe /ose të njëvlefshme, të cilat do të garantojnë cilësinë e produktit ose standart ISO me e avancuar, e perkthyer e noterizuar. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të cilët janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në të cilën gjejmë të përcaktuar se:” 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë“.*

Ky kriter gjë në mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë,

Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr.145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit dhe te ndërrimit te gomave te Automjetit (sipas nevojave te autoritetit kontraktor)** në adresat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **deklaratë mbi garancinë e gomave**, garancia e kilometrazhit të përshkruar në shfrytëzim normal sipas kushteve teknike të shfrytëzimit do të jetë jo më pak se 30,000 (tridhjetë mijë) km. Operatori ekonomik i shpallur fitues gjatë periudhës së garancisë është i detyruar të kryejë zëvendësimin e gomave me difekt për shkak të prodhimit osë cilësisë së dobët, pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 6 të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky vetdeklarim kërkohet për të vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të produkteve objekt prokurimi.

2.3.6 Operatori ekonomik të paraqesë **katalogë/broshurë të gomave**, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar). Në katalogë/ broshura duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) artikujt goma dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST. Katalogët/broshurat duhet të shoqërohen me një listë të gomave sipas tabelës së përgjithshme ku të specifikohen të dhënat si vijon:

Nr.	Emërtimi i artikullit (gomës)	Njësia	Sasia	Emërtimi kompanisë prodhuese	Emërtimi i katalogut	Referenca, kodi i mallit	Numri i faqes në katalog	Standarti i Cilësisë ISO
-----	-------------------------------	--------	-------	------------------------------	----------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------

Argumentim: Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe brenda afatit të percaktuar në kërkesën për dorëzim dokumentacioni pranë AK, dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të parashikuara në pikën 2 të nenit 26 të VKM-se 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Loti 3 “Blerje vaj, filtra dhe materiale të tjera”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, neni 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

c. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

5. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.

6. Të jetë i specifikuar në QKB objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik i njëjtë ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcen 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023-2024-2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së secilit prej loteve/shumatores se loteve për të cilat konkuron.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe pikat 1,2,3 të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për **këstet e maturuara të vitit 2026** sipas afateve të përcaktuara në ligjin 9632/2006 “Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kësaj deklaratë duhet ti bashkëngjiten të gjithë vërtetimet që deshmojnë se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet perkatese**, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për këto periudha.

Shënim: Ky kriter (2.2.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 pika 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së secilit prej loteve/shumatores se loteve për të cilat konkuron.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- e) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

- f) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Ofertuesit duhet të paraqesin Çertifikate ISO 9001:2015, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësive dhe /ose të njëvlefshme, të cilat do të garantojnë cilësinë e produktit ose standart ISO me e avancuar, e perkthyer e noterizuar. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit, të cilët janë akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në të cilën gjejmë të përcaktuar se:” 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”.

Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr.145 prot, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësive”.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se do të bëjë dorëzimin e mallrave sipas sasise dhe specifikimeve teknike të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 6 të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky vetdeklarim kërkohet për të vërtetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të produkteve objekt prokurimi.

Ofertuesi i kualifikuar i pari duhet te dorëzoje përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe brenda afatit te percaktuar ne kerkesen per dorezim dokumentacioni prane AK, dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të parashikuara në pikën 2 të nenit 26 te VKM-se 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punes, në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, te ndryshuar si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja per mallrat e kerkuar nga AK, me qellim mirembajtjen e automjeteve ne pronesi te NMIPP .

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Specifikimet teknike gjenden te ngarkuara ne DST.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e Prokurimit